

## SYLLABUS I LËNDËS SOCIOLOGUISTIKË

Të dhëna bazike të lëndës	
Fakulteti/Departamenti	Fakulteti i Filologjisë/Gjuhë dhe Letërsi Shqipe
Titulli i lëndës	<b>Sociolinguistikë</b>
Programi	<b>Gjuhë dhe Letërsi Shqipe</b>
Niveli	Bachelor
Statusi i lëndës	Obligative
Viti i studimeve	Viti IV, semestri VIII
Numri i orëve në javë	2+2
Vlera në KREDI-ECTS	4
Koha/lokacioni	Semestri veror
Mësimdhënësi i lëndës	<b>Prof. asoc. dr. Flamur Shala</b>
Detajet kontaktuese	<a href="mailto:flamur.shala@uni-prizren.com">flamur.shala@uni-prizren.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Objekti i sociolinguistikës: Sociolinguistikës dhe disiplinat e tjera. Sociolinguistika dhe gjuhësia. Pasqyrë e studimeve sociolinguistike të huaja e shqiptare. Zhvillimi sociolinguistik i fëmijës. Rreth përvetësimit të të folurit nga fëmija: roli i imitimit dhe i modelit që i jep fëmijës bashkësia shoqërore përkatëse. Gjuha dhe shoqëria; bashkësitë shoqërore, bashkësitë gjuhësore dhe bashkësitë komunikuese, njësitë gjuhësore dhe ndërlidhja e tyre shoqërore. Disa shqyrtime rreth eufemizmave të shqipes. Varietet gjuhësore – gjuhët, dialektet, sociolektet dhe regjistrat. Gjuhët standarde dhe formimi i tyre; standardizimi i gjuhëve ballkanike. Formimi i shqipes standarde. Kontaktet gjuhësore, ndërrimi i kodit dhe ndryshimi i stilit. Kontaktet e shqipes me gjuhët e tjera në takim në rrethin e Prizrenit. Gjuha, kultura dhe mendimi. Të folurit si bashkëveprim shoqëror. Studimi sasior i ligjëritimit. Metodot e studimit sasior të ligjëritimit. Pabarazia gjuhësore dhe pabarazia shoqërore.</p> <p>Paragjykimi gjuhësor: stereotipat, paragjykimet e mësuesve dhe të nxënësve. Roli i faktorëve shoqërorë në përshtatjen e të folurit. Përshtatja gjuhësore. Sociolinguistika e zbatuar. Disa probleme sociokulturore. Diferenca shoqërore dhe sjellja gjuhësore: mosha, gjinia, grupi etnik, niveli arsimor etj. Gjuhët në takim (kontakt). Shumëgjuhësia, dygjuhësia dhe diglosia. Gjuhët pixhin dhe kreole. Realiteti gjuhësor në Kosovë dhe statusi i tyre. Sprovë për një shqyrtim sociolinguistik të ndikimit të shqipes nga gjuhët e tjera fqinje jofqinje.</p>
<b>Qëllimi i lëndës</b>	<p>Qëllimi kryesor i këtij kursi është që studentët të njihen me format e studimeve gjuhësore në raport me bashkësitë shoqërore. Është me rëndësi që të kuptojnë ndikimin e faktorëve shoqërorë në ligjëritim dhe të jenë në dijeni për varietetet e ndryshme gjuhësore që ekzistojnë në kuadër të një bashkësie shoqërore dhe në këtë kuptim të njihen edhe me variacionin gjuhësor të gjuhës shqipe. Duke u bazuar në studimet e ndryshme sociolinguistike të nxjerra nga përdorimi i gjuhës, ky kurs fokusohet në atë se si gjuha konstrukton dhe i reflekton strukturat e ndryshme shoqërore dhe ndikimin e tyre në gjuhë, si dhe rolin e faktorëve shoqërorë në përcaktimin e formës së ndërkomunikimit njerëzor.</p>
	<p>Pas përfundimit të suksesshëm të lëndës, studenti:</p> <ol style="list-style-type: none"><li>1. Di për historinë e formimit të sociolinguistikës si disiplinë gjuhësore;</li><li>2. Njeh konceptet themelore të sociolinguistikës dhe problemet themelore sociolinguistike të gjuhës shqipe;</li><li>3. Aplikon teoritë gjuhësore për studimin e sociolinguistik të gjuhës;</li></ol>

<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>4. Vlerëson rolin dhe rëndësinë e zhvillimit të gjuhës në konsolidimin dhe zhvillimin e shoqërisë; njeh varietetet e ndryshme të gjuhës shqipe, krahas gjuhës standarde, dhe ta njohin historinë e procesit të standardizimit të shqipes;</li> <li>5. E kupton ndërvarësinë e dukurive gjuhësore me dukuritë shoqërore, politike e kulturore;</li> <li>6. Krahason përdorimin e gjuhës në situata të ndryshme të të njëjtit folës;</li> <li>7. Zhvillon shkathësitë e komunikimit, sipas situatave gjuhësore;</li> <li>8. Zbaton metodat e studimeve sociolinguistike të ligjërimit dhe është në gjendje të bëjë hulumtime sociolinguistike;</li> <li>9. Shkruan dhe zhvillon punime seminarike.</li> </ol>
--------------------------------	--

**Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime	2	15	30
Përgatitja e punimit të seminarit	1	5	5
Detyra –analizë sociolinguistike	1	10	10
Parapërgatitja për testin e parë (gjysmësemestral)	1	5	5
Konsultime	1	10	10
Parapërgatitja për testin (provimi) përfundimtar	1	10	10
<b>Ngarkesa totale</b>			<b>100 orë (ECTS)</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, ushtrime, seminare, prezantime, bashkëbisedim, konkretizim.
-------------------------------------	--

<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	<p>Seminari, testi gjysmësemestral, prezantimi, testi përfundimtar.</p> <p>Testi gjysmësemestral ka -25 pikë  Të gjitha aktivitetet -20 pikë  (vijueshmëria, seminar, prezantime, detyra)  Testi përfundimtar -55 pikë  Total: 100 pikë</p> <p>Vlerësimi me pikë  01-49=5, 50-60 =6, 61-70=7, 71-80 = 8, 81-90 = 9, 91-100=10</p>
-----------------------------------	---

**Literatura**

<b>Literatura primare:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Gjovalin Shkurtaj, <i>Sociolinguistikë e shqipes</i>, Tiranë, 2009.</li> <li>2. Richard A. Hudson, <i>Sociolinguistika</i>, Dituria, Tiranë, 2002.</li> <li>3. Janet Holmes, <i>Hyrje në sociolinguistikë</i>, Tiranë, 2015.</li> <li>4. Gjovalin Shkurtaj, <i>Sociolinguistikë e shqipes</i> (nga dialektologjia te etnografia e të folurit), Morava, Tiranë, 2013.</li> </ol>
----------------------------	---

<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>5. Gjovalin Shkurtaj, <i>Etnografi e të folurit të shqipes</i>, ShBLU, Tiranë, 2004; Morava, Tiranë, 2010.</li> <li>7. Rexhep Ismajli, <i>“Në gjuhë” dhe “për gjuhë”</i>, Dukagjini, Pejë, 1998.</li> <li>7. Rexhep Ismajli, <i>Standarde dhe identitete</i>, Dukagjini, Pejë, 2003</li> </ol>
---------------------------	---

**Plani i dizajnuar i mësim:**

Java	Ligjërata 2	Ushtrime 1
<i>Java e parë:</i>	Objekti i studimit të gjuhës në kontekstin shoqëror dhe kohor Sociolinguistika shqiptare ose etnografia e të folurit të shqipes	Studimi i gjuhës në kontekstin shoqëror Etnografia e të folurit të shqipes
<i>Java e dytë:</i>	Fushat e zbatimit të sociolinguistikës	Fushat e zbatimit të sociolinguistikës

	Ndryshimi dhe zhvillimi gjuhësor	
<i>Java e tretë:</i>	Përvetësimi i gjuhës Modelimi fillestar i gjuhës	Ndryshimi dhe zhvillimi gjuhësor - mësimi i gjuhës në shkollë
<i>Java e katërt:</i>	Komunikimi shoqëror	Komunikimi gjuhësor është shkëmbimi i informacioneve me anë të gjuhës
<i>Java e pestë:</i>	Bashkësia gjuhësore dhe bashkësia shoqërore	Grupimi i njerëzve sipas gjinisë e moshës, profesionit, arsimit etj.
<i>Java e gjashtë:</i>	Standardizimi i gjuhës si problem i përgjithshëm i sociolinguistikës së sotme - Nga dialektet te gjuha letrare	Varieteti standard dhe vlera shoqërore e kulturore e gjuhës së shkruar të përbashkët kombëtare
<i>Java e shtatë:</i>	Gjuhët kombëtare dhe gjuhët zyrtare në Bashkimin evropian	Gjuhët evropiane
<i>Java e tetë:</i>	Test gjysmësemestral	Përgatitja për test
<i>Java e nëntë:</i>	Individualizmi dhe konformizmi në gjuhë Strategjia dhe taktikat e ligjërimit	Shfaqja e individualizmit dhe konformizmit gjuhësor
<i>Java e dhjetë:</i>	Varieteti gjuhësor, të folmet e fshehta në krahinat shqiptare	Të folmet e fshehta
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Akti i të folurit – kompetenca komunikative	Kompetenca gjuhësore
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Gjuhët në kontakt – huazimet dhe situatat dy- dhe shumëgjuhëshe	Problemet e dygjuhësisë
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Përzjerja e kodeve (codsmixing) dhe prishja e kodeve (codswiching)	Raste të takimit të shqipes me gjuhët fqinje Përdorimi dhe funksioni i kodeve
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Rreth përvetësimit të të folurit nga fëmija	Përvetësimi gjuhës
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Shqyrtime sociolinguistike për emrat e farefisnisë dhe emrat vetjakë të shqipes	Emrat e farefisnisë dhe emrat vetjakë të shqipes

#### **Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:**

Studenti duhet të respektojë rregullat e institucionit:

- Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në orën mësimore;
- Të mbajë disiplinën gjatë ligjëratave;
- Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e Kartelës studentore (ID-së) në teste dhe provim;
- Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimitdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.